


SHPREHIA ARKITEKTONIKE

Duke patur formë fjongoje, ndërtesa është pasqyrim i drejtpërdrejtë i funksioneve dhe programeve që zhvillohen brenda saj.


Auditori kryesor është i ndërprerë në "zemër" të tij ndërkohë që dy fundet shtrihen që të marrin funksionet respektive për hapësirën publike dhe atë administrative.

Fasada ka dy pasqyrime kryesore: "guaskën" e betonit të derdhur në kallëpe që krijon një strukturë në trajtë ure, dhe 2 fundet e hapur të cilat lidhin aktivitetin brenda teatrit me qytetin.



FASADA E PALOSUR: MBRËMJE ESTETIKE

Pavarësisht nga qasja e saj barazore si ndërtesë publike, koncepti i fasadës së jashtme rrjedh nga gjeometritë e mprehta të siluetave të një mbrëmjeje në qytet. Mbledhja e fasadës në majë merr inspirimin nga eleganca e papionit zyrtar dhe fjongos së perdes.



FASADA "DOLL HOUSE"

Ndarja e fasadës është reflektim i drejtpërdrejtë i programit që ndodhet pas saj, dhe krijon një "libër tregimesh" për publikun duke lejuar teatrin që të veprojë si një skenë më vete. Kjo qasje është e rrënjësuar në konceptin e grupit teatror, ku elementët e skenës janë simbolikë të hyrjes, hapësirës dhe tërheqin imagjinatën e shikuesve.